



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 17 shtator 2021, në mbledhjen e katërt (4) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 11:00

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Shpejtim Bulliqi, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi znj. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Nijazi Jashari, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim; dhe z. Besfort Kruma, toger, përfaqësues i FSK-së, z. Fevzi Jetullahu, përfaqësues i emergjencave civile; Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame.

Ndërsa munguan: znj. Albina Avdiu, kryesuese e Komitetit për Komunitete; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Besfort Kruma, toger, përfaqësues i FSK-së.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Szilvia Csontos Përfaqësuese e KFOR-it; Edolind Vishaj, përfaqësues i FSK-së (në zëvendësim të z. Besfort Kruma), z. Driton Velu, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe z. Vigan Salihu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

znj. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, përshëndetje të gjithëve, pasi që Kryetari është i zënë me punë, ne do të fillojmë me mbledhjen e KKS-së. Materialet konsideroj i keni marrë të gjithë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës

U miratua njëzëri.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 31 maj 2021

U miratua njëzëri.

2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë
- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

znj. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, fillimisht fjalën ia kaloi Komandantit të Stacionit të Policisë lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

z. Nijazi Jashari, Komandant i Stacionit të Policisë, theksoi, situata e sigurisë në rajonin e përgjithshëm në Stacionin e Policisë në Podujevë përkundër të gjitha vështirësive cilësohet brenda

perimetrave të sigurisë, nuk ka ndonjë rast që e destabilizon gjendjen e sigurisë dhe nuk kemi ndonjë indikacion për destabilizim gjendjes, përkundër fluksit të madh të mërgimtareve që kemi pasur këtë vit, pastaj punimet në magjistralen Podujevë-Prishtinë, zjarret të cilat kanë shkaktuar disa probleme, kolonat e gjata në pikën kufitare Merdar të cilat na kanë marrë energji dhe personel dhe kanë krijuar vështirësi në kryerjen e detyrave, kur i shtohet edhe mungesa në personel sepse ende personeli nuk është sipas strukturës organizative. Prej ditës që kam marrë detyrën unë jam i kënaqur punën edhe zyrtarët policor edhe me gjendjen e sigurisë, po them edhe një herë përkundër vështirësive të cilat shihen. Gjatë kësaj kohe janë kryer disa operacione, disa edhe në bashkëpunim me Drejtorinë rajonale, të cilat kanë pasur sukses sepse ju e dini ka qenë sezonë e dasmave, kontrole të lokaleve të dyshimta, siguria në trafik për parandalimin e rasteve të aksidenteve, parandalimi i hetimit të veprave penale, shtimi i pikave të kontrollit, kontrolli i lokaleve të dyshimta të cilat vërtet edhe komuna ka njohuri që ka telashe me disa lokale, sidomos me këto lokalet me muzikë natën të cilat muajin e fundit veç se kemi shqiptuar gjoba me nga 2.000 € disave brenda javës, zbatimi i masave të sigurisë në luftimin e pandemisë, realizimi i urdhërësive të gjykatave, takimet me KLSB- në që i kemi mbajtur në fshatin Orllan bashkë me përfaqësuesit e stacionit policor. Gjithashtu kemi gati planin operativ për fillimin e vitit shkollor, është caktuar personeli të cilët do të operojnë në rroba civile nëpër shkolla. Disa vetëm se i ceka por janë diku rreth 15 plane operative të cilat janë ende në vazhdim. Në muajin gusht i kemi 42 raste të aksidenteve të trafikut, tiketa të shqiptuara janë 445, tiketa për mos respektim të masave anti-covid 560, 5 raste aksidente trafiku godit dhe ik (shkaktimi i aksidentit dhe ikja nga vendi i ngjarjes). Nga data 31 gusht deri më sot janë gjositur 11 lokale për mos respektim të masave anti-covid, në vlerë nga 2.000 €, ku dy prej tyre që kam qenë edhe vet personalisht natën i kemi dënuar brenda javës 2 herë, sa për informim të juaj njëra është në fshatin Sfeçël dhe tjetra te ish fabrika Euroblloku si lokale muzike gjatë natës. Pra deri me 15.09.2021 janë shqiptuar 198 tiketa trafiku, tiketa të shqiptuara për shkak të mosrespektimit të masave covid deri më 15.09.2021 janë 900, ndërsa vetëm për muajin gusht 560 tiketa janë shqiptuar për mos respektim të masave anti-covid. Sa për informim, është rritur dukuria e dhunës në familje, por kjo si dukuri është jo vetëm në Podujevë, por në gjithë Republikën e Kosovës, gjatë muajve gusht-shtator 2021 janë 16 raste të dhunës në familje dhe sikurse e keni parë prej mediave në këtë periudhë janë të arrestuar 8 persona për dhunë në familje, 18 raste janë vjedhje të rënda, janë 9 pistoleta të konfiskuara, dhe 2 pushkë automatike AK47, 5 raste janë për përdorimin e narkotikëve, prej tyre 2 janë të arrestuar për përdorim të narkotikëve shitblerje dhe posedim ashtu siç i cilëson edhe ligji. Shumë pak raste ka që nuk kanë shkuar për tu ofruar ndihmë për vaksinim, nuk e di që ka ndonjë por aty ku kemi dëgjuar që ka nevojë e kemi dërguar njësinë e komunitetit. Në këtë aspekt Podujeva qëndron më mirë se sesa rajonet tjera. Sot përfundon java e 3-të me orar 12 orësh për shkak të masave të reja të Qeverisë së Republikës së Kosovës, policët janë lodhur por ne jemi në detyrë dhe nuk kemi çfarë të bëjmë. Fushata zgjedhore siç e dini ka filluar dhe ne jemi përgatitur dhe kemi caktuar njësinë e cila do të operoj gjatë fushatës zgjedhore, do të ishte mirë dhe do të na ndihmonte ndonjë inspektor i AVUK-ut, në zbatimin e masave dhe vendimeve të Qeverisë në parandalimin e covid 19 sepse ne jemi të obliguar që të i shqiptojmë gjobë por të ketë edhe ndonjë inspektor të me siguri do të na kishte ndihmuar më shumë. Komuna e Podujevës është komunë që ka më së shumti qendra të votimit, kështu që na duhen forca shtesë sepse shumë shpejt vije 17 tetori dhe duhet t'i mendojmë të gjitha, sigurisht që do të na ndihmojë Drejtoria e Përgjithshme. E shfrytëzoj rastin të falënderoj FSK- në pasi që është prezentë edhe përfaqësuesi i saj për një donacion maska 800 copë që i ka dhënë Stacionit Policor në Podujevë. Po ashtu falënderoj edhe KFOR-in për bashkëpunimin e deritanishëm dhe besoj që do të vazhdojmë edhe më tutje, gjithashtu e përsërisim përfaqësuesen e KFOR-it që tani e përfundon misionin ndërsa atyre që vijnë u ofrojmë bashkëpunim. Organeve komunale prej ditës së parë kur kam ardhur, e besoj që edhe të tjerët e kanë bërë, u ofrojmë bashkëpunim në çdo kohë në çdo situatë në kuadër të autorizimeve ligjore që kemi. Sot sikurse jeni në dijeni para gjysmë ore me zyrtarë tjerë policor për asistim isha në fshatin Gllamnik ku është duke u rrënuar një objekt pa leje ndërtimi. Po ashtu

kemi asistuar para një jave edhe gjatë rrënimit të një objekti në fshatin Lluzhan. Edhe njëherë e potencoj, bashkëpunimi ynë nuk do të mungojë në asnjë rast.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, në lidhje me lirimimin e trotuareve ku tërë verën jemi ballafaquar me pengesa, parkime të veturave në trotuare, kështu që kemi rrezikuar edhe sigurinë e qytetarëve, e që tani fillon edhe procesi mësimor, çfarë keni ndërmarrë, a keni ndonjë plan.

z.Nijazi Jashari, Komandant i Stacionit të Policisë, theksoi, ne e kemi planin operativ të gatshëm për fillimin e vitit shkollor, e sa i përket gjendjes së theksuar nga Nënkryetarja këtë e shohim edhe ne, edhe unë si qytetar, jo si pozitën që e kam, kjo është një pengesë që i pengon qytetarët, i pengon fëmijët, por do ta bëjmë maksimumin me policë me biçikletë ta rregullojmë këtë çështje sepse vërtetë mua më pengon e jo juve, por është çështje problematike në të gjitha qytetet, pra ka probleme, qytetarët anë vështirësi dhe janë të penguar gjatë lëvizjes, e sidomos ka qenë kautike gjatë kohës sa kanë qëndruar mërgimtarët, këtë duhet ta pranojmë publikisht, mirëpo do të bëjmë maksimumin që fëmijët tonë të shkojnë të qetë në shkollë, tani sa do të kemi sukses në rregullimin e kësaj gjendjeje mbetet të shihet, por ne duhet të i rrisim numrin e gjobave sepse përndryshe nuk vetëdijesohen. Në kuadër të planit për fillimin e vitit shkollor është e paraparë edhe kjo çështje.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, falënderojmë Komandantin e Stacionit të Policisë për informatën e paraqitur sa i përket gjendjes së sigurisë në Komunë, ndërsa në vazhdim fjalën e ka përfaqësuesja e KFOR-it.

Përfaqësuesja e KFOR-it, Szilvia Csontos, theksoi, nga ana e KFOR-it nuk ka asgjë për të raportuar, ne vazhdojmë ta kryejmë mandatin tonë. Me që jam këtu e pranishme dua ta shfrytëzoj mundësinë që t'ju falënderoj për bashkëpunimin, stafin e komunës, çdo institucion, policinë, e dhe banorët e Podujevës, unë vetëm se po e përfundoj misionin dhe për mua ky është takimi i fundit këtu, me të vërtetë kam kaluar shumë mirë, edhe njëherë faleminderit shumë për bashkëpunimin dhe hapësirën që më keni dhënë për punë. Unë do të zëvendësohem nga togeri Balin Mouner, faleminderit shumë.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, edhe ne ju falënderojmë për punën dhe bashkëpunimin e juaj gjatë kësaj periudhe dhe ju dëshirojmë suksese. Vazhdojmë me informatën e përfaqësuesit të FSK-së.

Përfaqësuesi i FSK-së, Edolind Vishaj, theksoi, gjendjen e sigurisë në Komunën e Podujevës konsiderojmë se situata është mjaft e qetë dhe shumë stabile, ndërsa sa i përket aktiviteteve të FSK në Komunë, në veçanti jemi fokusuar në masat covid ku kemi bërë shpërndarjen e maskave nëpër vende të ndryshme për qytetarët, policinë dhe çdo kund ku ka qenë nevoja. Shfrytëzoj rastin që të tregoj se jemi të hapur për çfarëdo bashkëpunimi me të gjitha institucionet dhe strukturat tjera relevante për atë që kemi kapacitete dhe autoritet.

3.Informatë lidhur me gjendjen e Pandemisë-Covid 19 në Komunën e Podujevës

- Shëndetësia

- Arsimi

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, fillimisht fjalën e ka drejtori i DSHMS-së, e pastaj besoj se do të na bashkohet edhe drejtori i DKA-së. Të shohim si qëndron Komuna e Podujevës sot me gjendjen e Pandemisë-Covid 19.

z.Driton Veliu, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, siç e dini situata epidemiologjike në Komunën e Podujevës në javën e fundit po vije duke u përmirësuar për shkak se në ditët e fundit numri i të infektuarve është në zvogëlim kurse numri i të shëruarve po rritet, gjendja epidemiologjike në baza statistikore në Komunën e Podujevës është: 6304 qytetar të shëruar, fjala është prej fillimit të epidemisë kemi tani, 435 raste aktive dhe 69 raste eksitus apo përfundim me vdekje, gjithashtu jemi duke vazhduar edhe me vaksinim domethënë afërsisht ose mesatarisht numri i të vaksinuarve sillet rreth 850 gjatë ditës, për dallim prej herëve të kaluara domethënë tani kemi filluar të vaksinojmë edhe ditën e diel. Javë më parë

kemi filluar edhe me ditën e shtunë kështu që 7 ditë të javës jemi duke i vaksinuar qytetarët tonë. Sa i përket vaksinimit në nivel të Kosovës jemi një prej Komunave me më së shumti të vaksinuar domethënë pas qendrave rajonale. Arsyeja është se ne kemi një qendër shumë mirë të organizuar të vaksinimit dhe për këtë shkak kemi një rezultat shumë bindës mirëpo edhe promovimi i shpeshtë i Komunës së Podujevës dhe DSHMS-së ka bërë që qytetarët ta kuptojnë me kohë se vaksinimi është e vetmja alternativë për luftën kundër covid-19, ne gjithashtu e shfrytëzojmë rastin që meqenëse jemi në fushatën zgjedhore ju bëjmë apel të gjitha partive politike sidomos organizatorëve të fushatës, shefave të shtabit të partive politike në Komunën e Podujevës që të jenë shumë vigjilent, të jenë shumë të kujdesshëm dhe ti zbatojnë me përpikëri masat anti covid edhe gjatë fushatës zgjedhore, gjithashtu i lusim qytetarët që të jenë shumë të kujdesshëm gjatë fushatës zgjedhore. Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me këtë temë urdhëroni. E ritheksoj, i kemi 69 raste të vdekjeve prej fillimit të pandemisë, por jo të gjitha këtu është fjala vetëm për vdekjet që regjistrohen në rastet aktive të Komunës së Podujevës, numri i vdekjeve mundet me qenë shumë më i vogël.

z.Nuhi Selimi, theksoi, lidhur me temën e vaksinës unë para dy mbledhjeve nëse nuk gaboje e kam bërë një kërkesë pranë Drejtorisë së Shëndetësisë mirëpo nuk është realizuar ajo që është premtuar. Kam theksuar se është mirë të i shpërndani vaksinat nëpër teren. Duke marrë përbazë aspektin gjeografik territori i Komunës së Podujevës është shumë i hapur mirëpo nuk është bërë asgjë aty. Çështje tjetër është gjobitja e qytetarëve që nuk po bartin maska. Gjendjen e sigurinë e prishim ne pushteti, e asnjëherë të tjerët, shtresa e vogël, kjo është e vërtetë sepse lejojnë grumbullimet. Unë kam qenë për tu vaksinuar dy herë, mirëpo është e tmerrshme të presësh 2-4 orë 100 persona brenda në sallë për vaksinë, që ka mundur të vijë te infektimi me virus fare lehtë. Është një papërgjegjësi totale e jona për grumbullimin e njerëzve në një vend. Nuk po them që janë fajtorë DSHMS-së e Komunës, sepse faji është nga lartë mirëpo ne duhet të mendojmë për popullin tonë, e unë e kam prej përvojës sepse kam punuar në arsim kohë të gjatë dhe gjithmonë i'u kam përshtatur dhe gjithë arsimtarëve ju kam thënë përshtatuani nxënësve kushtet që vijnë prej kësaj ane, sepse nuk mundesh të përshtatësh nxënësin e Podujevës me të Prishtinës ose me të fshatit Orllanë, gjithmonë ka qenë kjo. Besoj që me shpërndarje nëpër tri qendrat Kërpimëh-Lluzhan-Orllan, shumë më pak kishim pasur njerëz të infektuar në Podujevë. Unë dëgjova komandantin e policisë, ku thotë se 560 qytetar janë të dënuar për maska, do të thotë sa ka efekt dhe sa kemi qëlluar në atë se ne po i shohim gjërat se si janë duke shkuar. Paritë politike grumbullohen pa pyetur fare 200 persona, pse ta dënosh një qytetar të shkretë që ndoshta është dalë të marr ndonjë barnë apo diçka tjetër në qytet dhe harron, sepse edhe mua më ndodh shumë shpesh që harroj. Besoj që me i trajtuar ato që i thashë kishte me qenë situata më mirë.

z.Driton Veliu, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, sa i përket decentralizimit për vaksinim kur është fjala për zhvendosjen e ekipeve të vaksinimit edhe nëpër disa qendra të mjekësisë familjare, si në fshatrat Kërpimëh- Orllan- Lluzhan, ne kemi bërë kërkesë në Ministri të Shëndetësisë mirëpo ata akoma nuk kanë marr një vendim për të rritur numrin e ekipeve, arsyeja është për shkak se numri i vaksinave të kontraktuara nga kompania Phizer ato stokat që vijnë kanë qenë të kontraktuara atij lloji që nuk kemi mundur të shkojmë mbi 1000 doza të vaksinave të administruara brenda ditës dhe ne me këto ekipe që i kemi dhe me atë sasi të vaksinës domethënë nuk ka pasur mundësi që të zgjerohet nëse na kishte ardhur mundësia që të ketë të kontraktuar më shumë vakcina Phizer brenda javës, atëherë ne kemi pasur mundësi dhe flitet që të bëhet deri në 2000 numri të vaksinuarve dhe të bëjmë decentralizimin por përderisa ka qenë numri i kontraktuar i dozave të vaksinës na është dashur të shkojmë kështu sado që ne kemi pasur mundësi me ekipe tona prej QKMF-së që me shtri vaksinimin edhe nëpër QMF-të tjera por ka qenë problemi tek kontraktimi i dozave të vaksinave. Tani po presim, e kemi bërë edhe kërkesën por edhe jemi në diskutime me Ministrinë e Shëndetësisë që është organi përgjegjës kryesor së bashku me komitetin për tu rritur numri i ekipeve të vaksinimit dhe kjo për arsye se e kemi marr një donacion të madh nga SHBA-të prej 500.000 vakcina domethënë se kemi mundësi tani më shumë që të relaksohemi me numrin e dozave të administruara edhe pse jemi mirë me numrin e të vaksinuarve, tashmë shifra ka kaluar 1 milion të administruara por kemi

mundësi që shpresoj që në javët në vazhdim të fillojmë edhe me vaksinim të hapur që kanë filluar disa shtete të rajonit dhe të fillojmë vaksinimin e fëmijëve prej 12 deri në 18 vite. Sa i përket grumbullimit tek salla e vaksinimit ne bashkëpunojmë me Policinë e Kosovës të cilët e mbajnë rendin shumë në nivel.

z.Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan, theksoi, fjala është për ta rritur numrin e stafit sepse në lokacionet (Kërpiemeh, Lluzhan dhe Orllan) mund të dërgohen vetëm 30-40 vaksina dhe nuk ka pasur nevojë të dërgohen më shumë brenda ditës.

z.Driton Veliu, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, nuk ka pasur më shumë se 1000 vaksina dhe vaksina Phizer është shumë e ndjeshme në ruajtje, e të mos kesh friz të veçantë është lehtë me humb kështu që ne i kemi marr javë më javë. Sa i përket dënimit policia është përgjegjëse në kuadër të autorizimeve ligjore që ka dhe këta janë të detyruar të shqiptojnë gjoba, si masë për shkak të mosrespektimit të masave anticovid.

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi, posedimi i maskës është çështje personale, ne nuk mundemi të garojmë me të tjerët mbase ky nuk po e vendos maskën nuk po e vendos as unë sepse është për të mirën tonë.

z.Driton Veliu, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, fati që numri i të infektuarëve është zvogëluar dhe numri i të vaksinuarve po rritet, domethënë masat dhe rekomandimet e reja të shëndetit publik janë efektive. Penalizimi i qytetarëve nga ana e Policisë është diçka tjetër por këta nuk kanë bërë asgjë tjetër vetëm kanë zbatuar vendimet dhe rekomandimet e IKSHP-së.

z.Nijazi Jashari, Komandant i Stacionit të Policisë, theksoi, brenda ditës i kemi shqiptuar 100 gjoba, disa ditë më parë, mirëpo tani jo tani numri i gjobave sillet rreth 40 sepse tani edhe po frigohen nga pak dhe janë vetëdijesuar dhe po i mbajnë maskat kur dalim në shesh, shumë pak njerëz sheh pa maskë.

z.Driton Veliu, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, duhet ti respektojmë masat sepse numri të infektuarëve ka rënë por nuk do të thotë që është hequr virusi, është këtu dhe ne kemi arritur 286 mostra t'i dërgojmë në gjermani për identifikimin e mutacionit të ri të virusit, varianti mu dhe ne duhet të jemi shumë vigjilent sidomos gjatë fushatës zgjedhore, kështu që kërkoj nga policia që me masat të jeni sa më vigjilent dhe të respektohen edhe nga partitë politike pasi që numri i të infektuarve mundet të rritet shumë pasi që ne dimë mos ti respektojmë nga pak masat, sepse po kushton më vonë.

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi, a ka ndokush diçka që dëshiron ta marr fjalën lidhur me shëndetësinë, nëse nuk kemi atëherë vazhdojmë sepse është paraparë edhe informata nga DKA mirëpo drejtori DKA-së është në një takim tjetër dhe besoi që vjen para se të përfundoj takimi dhe ne tani kishim kaluar tek pika e radhës.

z. Edolind Visaj, Përfaqësuesi i FSK-së, theksoi, pasi që jemi tek vaksinimi vetëm desha të ju njoftoj që FSK ka nisur një projekt të ri që të shpërndaj maska para fillimit të vitit shkollor në të gjitha shkollat e Kosovës dhe desha ta falënderoj drejtorin e DKA-së që ka qenë shumë i hapur për bashkëpunim domethënë informatat që i kemi kërkuar prej tij për shkollat, gjendjen e tyre numrin e nxënësve në lokacione ka qenë shumë i shpejtë dhe i saktë në informatat që na kanë jap dhe desha ta falënderoi për këtë gatishmëri, të bashkëpunoj me FSK-në.

4. Informatë për gjendjen e pyjeve

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, fjalën e ka drejtori i DBPZHR-së.

z.Vigan Salihu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR, theksoi, sa i përket sektorit të pylltarisë nga rojet e pyjeve për prerje ilegale janë ngritur 175 fletëparaqitje prej tyre 11 janë penale mbi 2 m³ dhe 164 janë kundërvajtje nën 2 m³, si rezultat i kontrolleve të zhvilluara janë konfiskuar 130.73 m³ apo 190.86 metër hapësinor janë realizuar 3 revizione pyjore Bradash-Sllatinë-Tërrnavicë, nga pronarët e pyjeve private janë parashtruar 283 kërkesa prej tyre nga ana e zyrtarëve të Agjensionit Pyjor të Kosovës janë shqyrtuar 206, janë lëshuar 64 leje për prerje pylli në prona private. Zjarre pyjore kemi pasur në 16 raste, kryesisht

me intensitet të ulët dhe të mesëm në sipërfaqe prej 67.20 ha prej tyre në prona publike janë 19.15 ha, ndërsa në prona private janë 48.05 ha. Në bashkëpunim me Agjencinë Pyjore të Kosovës do të pyllëzohen 15 ha në fshatin Murgull, 10 ha në fshatin Revuqë dhe për vitin 2022 janë paraparë 30 ha në fshatin Ternavicë.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, falënderojmë Drejtorin për informatën e paraqitur, nëse nuk keni diçka rreth kësaj kalojmë në pikën të ndryshme.

5. Të ndryshme

z.Liman Zeqiri, theksoi, e falënderoi komandantin e policisë për informatat e paraqitura, do ishte mirë edhe prej drejtorëve të kemi informatat me shkrim. Desha ta pyes komandantin si qëndron me staf dhe sa e mbulon territorin e Komunës së Podujevës, konkretisht a ke mungesë të stafit.

z.Nijazi Jashari, theksoi, unë e ceka edhe në fillim, sa kam informata është duke u punuar struktura e re organizative e në kuadër të strukturës së re organizative aty edhe precizohen secili stacion sa duhet të ketë në bazë të kategorizimit. Sikurse jeni në dijeni Podujeva është në kategorinë A me faktor dhe parametra sa duhet të ketë staf, momentalisht ne kemi mungesë të stafit, me shifra nuk mundem të flas pasi që nuk i kam të gjitha, stafi duhet të plotësohet por duhet të presim sepse deri në këto ditë nuk kemi pas të drejtë as konkurs të brendshëm të shpallim për nevojat proporcionale, para dy dite vetëm se është lejuar që të shpallet konkursi por unë sa di deri më sot informatat që i kam shumë shpejt ka për tu formuar struktura e re organizative, sepse ajo propozohet, shkon tek Ministri, e nënshkruan edhe Qeveria. Me kapacitetet që i kemi jemi duke operuar maksimalisht, ka edhe mungesë të eprorëve, të tjerat stacione nuk i kanë këto sidomos Prishtina ka staf të mjaftueshëm, ne edhe me këtë numër punojmë mirëpo mungesë stafi ka, edhe epror na duhen disa pozita së paku 2.

z.Nuhi Selimi, theksoi, dua të përcjell një kërkesë të bashkëqytetarëve të mi nga mbledhja e fundit të KLSB-së, ishte kërkesë me vend sepse shqetësimi është i tillë, gjatë sezonës së verës sidomos familjarët tanë kur po kthehen nga jashtë po orientohen të shkojnë në pikën kufitare të Mutivodës, po kanë telashe njerëzit, po u marrin para për me i end poshtë e përpjetë. Është një hapësirë e madhe dhe është një kërkesë e qytetarëve me i vu shenjat e orientimit në çoftë se ka mundësi. Në fshatin Orllan qytetarët i kanë vendosur shenjat tek rruga që kthehet për Mutivodë, Personat që i drejtojnë këta me para i detyrojnë të kalojnë nëpër fshatin Koliq për t'iu marr para pak më shumë. Është shumë e nevojshme Komuna t'i vendos shenjat orientuese për pikën kufitare të Mutivodës, duke filluar nga Podujeva.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, çështjet që janë në domenin e Komunës sigurisht që do t'i rregullojmë dhe do të marrim parasysh edhe intervenimin mirëpo nëse kjo i përket Ministrisë së Infrastrukturës atëherë e kemi pak më problem që të veprojmë por bashkërisht me drejtorin do të gjejmë zgjidhje.

z.Nijazi Jashari, theksoi, në kuadër të KLSB-së Orllan ka pasur kërkesa dhe janë debatuar edhe çështje tjera. Një prej kërkesave ka qenë vendosja e disa kontejnerëve të mëdhenj te pjesa e Liqenit, sidomos gjatë sezonës së verës, kërkesa është parashtruar prej përfaqësuesve të fshatrave për kontejnerë të madhësisë më të madhe për ta mbrojtur ambientin kjo ka qenë që e kam pasur edhe të shkruar, ka pasur edhe kërkesa të tjera por kjo ka dalur dhe e pashtë të nevojshme ta paraqes këtu.

z.Nuhi Selimi, desha të shtoj diçka por meqenëse nuk është kryetari prezent, sepse ai po sillet më shumë dhe po sheh gjerat në regjionet tjera, e në Orllan jo, në vitet e kaluara janë angazhuar nga dy punëtorë të pastrimit për ta mirëmbajtur por këtë vit është lënë mbas dore e gjitha, këtë të gjithë po e shohin.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, sot është aksion në Orllan për pastrim. Meqenëse tani është edhe drejtori i arsimit z. Avni Fetahu, vazhdojmë me informatën rreth arsimit.

z.Avni Fetahu, theksoi, ne kemi bërë përgatitjet e nevojshme sa i përket fillimit të procesit mësimor edhe pse është shtyrë deri me 26 shtator 2021. Përveç pastrimit dhe higjienës prej vet menaxhmentit të shkollës kemi kontraktuar edhe kompani e cila merret ekzpluzivisht me këtë

çështje dhe e cila e ka për obligim me vendos tikitën që është kryer dezinfektimi, dehidratizimi dhe format të tjera që i ka kompania. Sa i përket përgatitjeve tjera që i duhen shkollave janë në nivel të duhur kurse ajo që lidhet me siguri është për fat të mirë që për herë të parë mbas 10 viteve është lidhur kontrata me kohë për transport dhe nuk e kemi asnjë problem komform udhëzimit administrativ siç e parasheh që çdo 2-4 kilometër të bëhet transporti i nxënësve. Kemi bërë një investim dukshëm në 20 shkolla, së paku tek rrethojat që ndikon pozitivisht edhe tek siguria e nxënësve, jemi në përpjekje në koordinim me Drejtorin e Inspeksionit disa trafika që ekzistojnë dhe kioska afër shkollave me bë një zgjedhje më ideale për ato ose me gjete formën me i vendos brenda ose me i tërheq.

z.Mensur Hoti, neve si Bashkësi Islame këtu në Podujevë me datën 07.07.2021 kemi bërë kërkesë për një parcelë të na mundësohet për varreza dhe për mirëmbajtje të varrezave. Ankesat ndaj Bashkësisë Islame janë të tmerrshme nga qytetarët, mirëmbajtja e varrezave nuk qëndron aspak mirë në qytetin e Podujevës por as nëpër fshatra, disa fshatra kanë bërë marrëveshjen me Kompaninë Natyra ose dikën tjetër ti mirëmbajnë, mirëpo qyteti nuk ka pasur zgjidhje të këtillë. Kur kam biseduar me kryetarin z.Shpejtim Bulliqin më ka thënë se kemi me ndarë subvencione për këtë çështje, ndërsa në ndërkohë doli një kronik nga TV-Llapi dhe Drejtori z.Fevzi Jetullahu tha se nuk kemi ndarë as një lloj buxheti për mirëmbajtje të varrezave. Ju duhet me ndërmarr diçka në lidhje me këtë çështje ose unë si Bashkësi Islame më duhet të dal me një komunikatë në faqen zyrtare të Bashkësisë Islame që fundja nuk është përgjegjësi e jona gjetja e parcelës të varrezave dhe mirëmbajtja e varrezave, pra kjo nuk është çështje e jona dhe nuk mundemi me i mirëmbajtë sepse nuk kemi buxhet për atë çështje.

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi, e keni kërkuar parcelën për varreza të qytetit apo

z.Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame, theksoi, po për varreza të qytetit ka një muaj që është bërë kërkesa asnjë përgjigje nuk kemi as negative as pozitive në këtë çështje.

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi, kemi bërë kërkesë për shpronësim të tokës në Ministri tash shpresoj se ka për të kthyer përgjigje Ministria dhe besoi që ka për tu zgjedh.

z.Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame, theksoi, në çoftë se është zgjedh nuk kanë dal me asnjë komunikatë sepse sulmet ndaj Bashkësisë Islame janë të mëdha sepse po mendojnë qytetarët që ne të Bashkësisë Islame duhet të ua bëjmë zgjedhjen për varreza si për mirëmbajtjen e tyre kështu që është çështje fushate nuk mundemi me dal me asnjë reagim në faqen zyrtare të Bashkësisë Islame.

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi, për çështjen e varrezave është dorëzuar kërkesa për shpronësim, dhe jemi në pritje të përgjigjes nga Ministria, ndërsa sa i përket mirëmbajtjes tani e pash që e ka fituar një Kompani që ka për të bërë mirëmbajtjen e varrezave.

z.Mensur Hoti, theksoi, presim një përgjigje sepse kanë kaluar 2 muaj e më shumë dhe nuk kemi asnjë përgjigje lidhur me këtë çështje.

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi, pa marrë ndonjë përgjigje nga Ministria përkatëse nuk e di se si të ju kthejmë juve përgjigje z.Mensur Hoti. Është Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë ajo që ka bërë kërkesën për shpronësim, tani po presim përgjigjen nga ana e Ministrisë dhe në momentin që na kthen përgjigje Ministria ne ua kthejmë juve.

Nënkrjetarja përfundoi mbledhjen, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr. 02-060/040084153/21
Podujevë, 17 shtator 2021

Nënkrjetarja e Komunës
Marigona Lahu